

## NË KËTË NUMËR

Mjaft! këshillon për avokim të efektshëm **2**

AvoKo Punëson një Koordinator **2**

OJQ-të mësojnë për rolin e forcës policore të Kosovës **3**

OJQ-ja kërkon Ligj për Njerezit me Kufizime Mendore **3**

OJQ-ja Jeto Jetën avokon për të drejta të barabarta transporti **3**

Bizneset, qytetarët kërkojnë transaksione monetare më të shpejta **4**

Haradinaj thirret në Hagë **4**

## Ngjarjet e ardhshme

## Ngjarjet e ardhshme në ATRC:

**E premte, dt. 10 prill, mbahet një diskutim publik për "Decentralizimin dhe planet pilot".**

**E mërkurë, dt. 21 prill, do të mbahet një punëtori mbi "Si punon qeverija".**

EAST • WEST  
MANAGEMENT  
INSTITUTE

## Aktakuza ndaj Haradinaj sjell një mars të trazuar

Prishtinë, mars. Para shkrirjes së borës, në një nga ditët e para me diell të pranverës, kosovarët morën disa lajme të papëlqyeshme. Ramush Haradinaj, Kryeministër i Kosovës që nga tetori i vitit 2004 dhe ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për rajonin e Dukagjinit gjatë luftës, iu dha aktakuza nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime në ish-Jugosllavi (ICTY) për akuzat të ndryshme lidhur me keqtrajtimin e pakicës serbe dhe ekzekutimin e "bashkëpunëtorëve" shqiptarë.

Haradinaj e informoi publikun për aktakuzën përmes një konference emocionale për shtyp, e cila u përcoll me shumë interes nga një audiencë e shokuar dhe shumë herë me lot në sy. Haradi-

naj u lut për paqe dhe stabilitet në Kosovë, duke shpjeguar se atij i duhej ta bënte këtë pushim në Hagë.

Publiku kosovar e përkrahu Kryeministrin dhe shoqëria civile tregoi mbështetjen e vet duke qarkulluar një peticion. Një letër, e hartuar me ndihmën e ATRC-së, iu dërgua Gjykatës së Hagës. Pjesë nga kjo letër mund të lexoni në këtë numër të "Avokimit".

Që nga shpallja e aktakuzës për



Z Haradinaj pranoi paqësisht akt-akuzën e Gjykatës së Hagës (Foto e marrë nga AP.)

Haradinajn, ka patur protesta paqësore dhe një shfaqje të vogël dhune. Një granatë dore shpër-

Vijon në faqe 4, Haradinaj

## ATRC dhe FDI-ja e informojnë publikun për të drejtën e pjesëmarrjes në vendim-marrje

Si pjesë e Projektit për Pjesëmarrje Publike, që financohet nga Trusti i Ballkanit për Demokraci dhe zbatohet nga FDI-ja dhe ATRC-ja, ATRC-ja organizoi gjashtë trajnime në tre komuna: Klinë, Istog dhe Dragash. Më shumë se 70 pjesëmarrës i ndoqën këto trajnime, që u mbajtën mes datave 21 dhe 30 mars.

Qëllimi i Projektit të Pjesëmarrjes Publike është rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje, përmes granteve për OJQ-të, trajnimeve për zyrtarët komunalë dhe shoqërinë civile, dhe diskutimeve publike.

"Si ta lehtësojmë pjesëmarrjen publike" dhe "Krijimi i marrëdhënieve me qytetarët për pjesëmarrje më të mirë publike dhe legjislacioni ekzistues për pjesëmarrjen publike" ishin temat e trajnimeve të ofruara për autoritetet vendore (zyrtarët komunalë) dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në

këto komuna. Trajnimet u organizuan për të ngritur kapacitetin dhe njohurinë e OJQ-ve, qytetarëve dhe zyrtarëve qeverisës për rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes publike në vendim-marrje.

Trajnerët, profesor Enver Hasani nga Universiteti i Prishtinës dhe trajneri i KNAP-it Emrush Azemi, ofruan shembuj nga vende të ndryshme për lehtësimin sa më të mirë të pjesëmarrjes publike. Ata poashtu i angazhuan pjesëmarrësit në përpjekje planifikimi që ata mund t'i ndërmarin për rritjen e pjesëmarrjes publike, sipas nevojave të tyre.

Ndërkohë që disa pjesëmarrës ishin shumë të familjarizuar me të drejtat qytetare, të



Trajnimet u mbajtën në disa qytete të vogla të Kosovës.

tjerët kishin shumë pak njohuri për të drejtat dhe detyrimet e tyre. Siç duket, ngelet edhe shumë për t'u bërë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes publike në vendim-marrje. Si zyrtarët komunalë dhe shoqëria civile kanë nevojë për trajnime të mëtejshme sepse kjo është një formë e re e qeverisjes dhe të gjithë aktorët sapo kanë filluar të njihen me rregullat e saj.

ATRC-ja dhe FDI-ja planifikojnë ta vazhdojnë Projektin e Pjesëmarrjes Publike duke organizuar diskutime publike në këto tre komuna. ■

## AvoKo Punëson Koordinatorin

Në mars, AvoKo-ja punësoi koordinatorin, Shqipe Pantina, për të organizuar veprimtaritë e rrjetit. AvoKo-ja është një rrjet i OJQ-ve vendore të orientuara në avokim që vepron në rajone të ndryshme nëpër Kosovë.

Pantina, një anëtare e AvoKo-së që nga krijimi i saj, u zgjodh nga anëtarët e tjerë të AvoKo-së prej një liste të gjerë aplikuesish. Ajo ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, ku ka studiuar Shkencat Politike. Ajo ka përvojë të mëparshme si koordinator e fushatës për Rrjetin e Grave të Kosovës.

Pantina do të drejtojë një fushatë të AvoKo-së për edukimin publik mbi Standardet e KB-së për Kosovën he do t'i ndihmojë rrjetit për rritjen e kapacitetit të vet për punët e ardhshme të avokimit.

ATRC-ja poashtu ka qenë anëtare e AvoKo-së që nga krijimi i rrjetit. ■

## AvoKo-ja fillon një fushatë edukative mbi Standartet për Kosovën

AvoKo-ja do të ndërmarrë një fushatë të edukimit publik lidhur me Standartet e KB-së për Kosovën. Kjo fushatë do të plotësojë përpjekjet e qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut për të informuar qytetarët për këto standarte dhe për procesin e implementimit të tyre. Duke synuar që të rrisë shkallën e përkrahjes së qytetarëve për procesin e implementimit të standarteve, AvoKo-ja do të angazhohet në një seri veprimtarish në nivel komunal, të cilat do t'i shërbejnë njohjes nga ana e qytetarëve të vlerës që ka zbatimi i këtyre standarteve për jetën e tyre, si dhe çmitizimit të standarteve dhe të përpjekjeve për zbatimin e tyre, sidomos të atyre standarteve që kanë të bëjnë me pakicat. ■

## Mjaft! këshillon për avokim të efektshëm

Prishtinë, 1-3 mars. MJAFT!, me qendër në Tiranë, dhe ATRC-ja bashkëpunuan për organizimin e një trajnimit mbi mënyrën e drejtimit të një fushate avokimi. Trajnimi u ndoq nga më shumë se një duzinë përfaqësuesish të OJQ-ve vendore, ku futen edhe OJQ-të e rrjetit AvoKo dhe të avokimit lokal. Arbian Mazniku dhe Marinela Lika, anëtarë themelues të MJAFT!-it, drejtuan trajnimin. Trajnimi u bë i mundur përmes një granti të Institutit të Menaxhimit Lindje-Perëndim, Inc., të financuar nga populli amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Përfaqësuesit e MJAFT!-it ndanë përvojat e tyre për organizimin e fushatave të mëparshme të avokimit në Shqipëri. Suksesi i këtyre fushatave dhe i lëvizjes qytetare



Arbian Mazniku nga Mjaft! ofroi një përshkrim të hollësishëm

shqiptare MJAFT! është vlerësuar nga bashkësia ndërkombëtare me grante dhe çmime, ku së fundmi kanë marrë çmimin prestigjioz të OKB-së për Shoqërinë Civile në vitin 2004.

Gjatë trajnimit, përfaqësuesit e MJAFT!-it folën për dy fushata specifike. E para çoi në ndalimin e ngritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe thirrjeve telefonike në Shqipëri.

Në këtë rast, MJAFT!-i i bëri presion qeverisë shqiptare, zotëruesja e vetme e të dyja kompanive: energjetike dhe të telekomunikacionit. Në rastin e dytë, MJAFT!-i ndaloi me sukses një kompani italiane që të importonte mbeturina për përpunim në një zonë të mbi-populluar të Shqipërisë. Grafiku në faqen vijuese ofron disa udhëzime se si të drejtohet një fushatë e suksesshme avokimi.

Mazniku theksoi rëndësinë e arritjes së qëllimeve strategjike, veçanërisht në fushata të profilit të lartë. "Falë sukseseve të profilit të lartë, tani ne jemi në gjendje që të zgjidhim shumë çështje përmes negociatave, nën kërcënimin e organizimit të fushatave të efektshme të profilit të lartë", shpjegoi ai. Si Mazniku edhe Lika theksuan nevojën e kërkimit të thellë të çështjes me të cilën do të merret fushata dhe të krijimit të marrëdhënieve me specialistët.

Pasi MJAFT!-i paraqiti punën e vet, pjesëmarrësit e trajnimit paraqitën temat e interesit për fushatat e ardhshme të avokimit. Ata diskutuan një strukturë të thjeshtë për fushatat e ardhshme. Trajnimet u mbyllën me ftesën e MJAFT!-it për pjesëmarrësit që të vizitojnë Tiranën dhe të takohen me pjesën tjetër të organizatës. Një datë e mundshme është vendosur tashmë dhe ATRC-ja do të bashkëpunojë për organizimin e kësaj vizite. ■

Cili është problemi?

Vendosni qëllimin e fushatës

Analizoni grupet e interesit

- Kush janë vendim-marrësit?
- Kush janë aleatët dhe partnerët?
- Kush janë grupet kundërshtarë?

Analizoni burimet

Përcaktoni strategjinë më të përshtatshme

Hartoni planin e veprimit

- Njerëzit e synuar për t'u ndikuar
- Datat e synuara
- Shpërndarja e detyrave
- Zhvillimi i strategjisë
- Përgjigjuni pyetjeve : kush, si, ku dhe kur

Përgatisni mesazhin tuaj

## Jetë Jetën Avokon për barazi në transportim

**Prishtinë, 2 mars.** ATRC-ja dhe "Jetë Jetën", përfituese e granteve të Fondacionit për Iniciativa Demokratike (FDI), bashkë-organizuan një debat publik për nevojat dhe të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara në Hotelin Grand, në Prishtinë. Debatin e përcollën më shumë se tridhjetë pjesëmarrës nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, komuniteti i biznesit dhe institucionet qeveritare.

Gjatë debatit, "Jetë Jetën" paraqiti gjetjet e studimit të vet për mungesën e mbështetjes institucionale për drejtuesit e automjeteve me "mundësi jo të plota fizike". Sipas studimit, rregullorja për aftësimin e drejtuesve të automjeteve nuk urdhëron që auto-shkollat të kenë nga një makinë për aftësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Auto-shkollat nuk posedojnë makina të tilla dhe ka shumë pak mekanikë që mund t'i modifikojnë makinat normale për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile kërkuan që zyrtarët e Ministrisë së Transportit ta ndryshojnë rregulloren, me qëllim lehtësimin e mësimin dhe lëvizjes së lirë për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Ndërsa anëtarët e Parlamentit, që ishin të pranishëm, i mbështetën ndryshimet e propozuara për rregulloren, pjesëtarët e komunitetit të biznesit e konsideruan si detyrën e tyre, e poashtu edhe burim fitimi, sigurimin e mundësive të barabarta për njerëzit me aftësi të ndryshme. ■

## OJQ-të mësojnë për rolin e forcës policore të Kosovës

**Prishtinë, 14 mars.** Në vazhdim të veprimtarive tona "Si funksionon qeveria", ATRC-ja organizoi një punëtori me temën "Roli i forcës policore të Kosovës dhe transformimi i saj i ardhshëm". Qëllimi i punëtorisë ishte njohja më e mirë e detyrave të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), pasi ai punon krejt ndryshe nga shumë forca të tjera policore, duke ofruar shërbime publike që zakonisht kryhen nga institucione të tjera. Punëtorja u ndoq nga më shumë se 20 pjesëtarë të organizatave qeveritare dhe OJQ-ve.

Kolonel Behar Selimi, Shef i Shërbimit Përkrahës të SHPK-së, shpjegoi kompetencat e SHPK-së. SHPK-ja është një institucion brenda pushtetit të rezervuar, që do të thotë se ende menaxhohet nga administrata ndërkombëtare e jo nga Parlamenti apo ndonjë Ministri. Në gjashtë vjet të

ekzistencës së vet, SHPK-ja është rritur dhe ka arritur një kapacitet prej 6200 policësh.

Steve Bennet, Drejtor i Shkollës Policore të Kosovës, përshkroi përpjekjet e shkollës, që kanë qenë një pjesë integrale e suksesit të forcës policore. Ai theksoi se Shkolla Policore e Kosovës siguron një shumëllojshmëri trajnimesh që në vende të tjera ofrohen vetëm nëpër shkolla të caktuara.

Nicholas Booth, Këshilltar i Lartë pranë zv. PSSP-së për Policinë dhe Drejtësinë, tha se Shtylla I e Misionit të Kombeve të Bashkuara në



Zyrtarë të policisë si dhe anëtarë të OJQ-ve vendore morën pjesë në debatin tonë

Kosovë (UNMIK) është në procesin e hartimit të një ligji. Ai ishte optimist se pushteti mbi SHPK-në do t'i kalojë shumë shpejt vendorëve.

Në përfundim, Steve Bennet i ftoi të pranishmit për një vizitë në Shkollën e Policisë për të parë nga afër se si po trajnohet policia e ardhshme për t'u bërë një forcë policore moderne. Ftesa u pranua dhe është planifikuar një vizitë në Shkollën Policore të Kosovës. ■

## OJQ-ja kërkon Ligj për Njerëzit me Kufizime Mendore

**Prishtinë, 10 mars.** Një diskutim publik mbi "Fillimin dhe Promovimin e Ligjit për Njerëzit me Kufizime Mendore" u organizua në Hotelin Grand, në Prishtinë, nga Shoqata për Asistencë Psikologjike për Fëmijët dhe Familjen (APACF). Më shumë se tridhjetë pjesëmarrës, ku futen edhe pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), të OJQ-ve vendore dhe Parlamentit, morën pjesë në debat. Debatit sintetizonte gjetjet nga debatet vendore në Gjakovë, Mitrovicë dhe Ferizaj. Ai poashtu merret në konsideratë edhe kornizën ligjore të Bosnje - Hercegovinës për këtë çështje. Të gjitha veprimtaritë janë mundësuar nga një grant i FDI-së.

Bazuar në gjetjet e debateve vendore të kaluara, OJQ-ja dha një pasqyrë të hollësishe të gjendjes së njerëzve me probleme mendore në Kosovë. Disa prej gjetjeve më shqetësuese përfshinin nevojën për ekspertizë për të siguruar që nuk abuzohet me njerëzit me kufizime mendore, dhe nevoja për bashkëpu-

nim të mëtejshëm me SHPK-në për të parandaluar abuzimin. Përdorimi ka pak specialistë për këtë degë të mjekësisë dhe vetëm pak institucione që merren me këto çështje,

APACF-ja rekomandoi që qeveria të ndihmojë për dërgimin e disa prej rasteve më të ndjeshme jashtë Kosovës, ku do të mund të mermin trajtimin e nevojshëm.

APACF-ja poashtu përmendi disa suksese, si profesionalizimi i shërbimit mjekësor dhe bashkëpunimi i kënaqshëm me SHPK-në.

"Gjendja nuk është as e zezë, e as e bardhë, por mund të jetë më e mirë", tha një përfaqësues i APACF-së. Një kornizë ligjore mund ta çonte përpara statusin e



Në seminar morën pjesë anëtarë të kuvendit dhe si dhe përfaqësues të forcave të rendit dhe OJQ-ve të ndryshme.

personave me kufizime mendore, tha ai.

Pjesëmarrësit debatuan rreth legjislacionit të propozuar, që bazohet në legjislacionin e Bosnjës. Ata komentuan për një projekt-propozim të vjetër që nuk u miratua kurrë, pasi dukej shumë i përparuar për kushtet e Kosovës. Një pjesëmarrës, anëtar i Parlamentit, premtoi se ai do ta paraqiste projekt-propozimin e ligjit në Parlamentin e Kosovës sa më shpejt që të ishte e mundur. ■

# atrc

Advocacy Training & Resource Center

Rr. Agim Ramadani, Nr. 15  
(ish Ramiz Sadiku)  
Kati i dytë Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 38 244 810

Fax: +381 38 244 810

Email: info@advocacy-center.org

## Drejtor

KRESHNIK BERISHA  
keka@advocacy-center.org

## Menaxhere e Përgjithshme

KIMETE KLENJA  
kimete@advocacy-center.org

## Menaxhere e Trajnimeve

NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

## Këshilltare

NICOLE FARNSWORTH  
nicole@advocacy-center.org

## Përgjegjës për Informim dhe Marrëdhënie me Publik

OERD IMAMI  
oerd@advocacy-center.org

## Kordinatorë e Projektit FOI

EMINE VALA  
emine@advocacy-center.org

## Administrator Zyre

GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

*Fondacioni për Iniciativa  
Demokratike është partneri  
kryesor zbatues i Projektit për  
Avokim të OJQ-ve Kosovare,  
i cili është një bashkëpunim i In-  
stitutit për Menaxhim  
Lindje-Perëndim (EWM) dhe  
USAID-it, i mundësuar nga  
fondet e popullit amerikan.*

## Bizneset, qytetarët kërkojnë transaksione monetare më të shpejta

Prishtinë, 25 mars. Në zyrat e ATRC-së u mbajt një diskutim publik me titullin "Si funksionon sistemi i pagesave në Kosovë". Ai u bashkë-organizua nga ATRC-ja dhe Klubi i Afarishtëve të Prizrenit (KAP). Në debat, KAP-i paraqiti studimin e vet mbi vonesat në transaksionet bankare në Kosovë. Debatu bashkoi përfaqësues të institucioneve të ndryshme të përfshirë në transaksionet monetare, brenda dhe midis bankave, për të diskutuar përgjegjësinë për vonesat e transaksioneve. Studimi dhe debati u bënë të mundur përmes një granti të FDI-së.

Përfaqësues të Bankës Botërore, OJQ-ve vendore, bizneseve të vogla, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Bankës së Pagesave të Kosovës (BPK), që shërben si bankë qendrore, dhe zv. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë ishin të pranishëm në debat.

Studimi i KAP-it tregoi se edhe pse transaksionet supozohet që të ndodhin brenda 24 orëve, ato shpesh marrin më shumë kohë - 2 deri në 60 ditë - që mund t'iu shkaktojnë humbje të mëdha bizneseve. Shkon deri në dy

javë për plotësimin e një transferi, edhe kur fondet transferohen brenda së njëjtës bankë, nga njëra degë në tjetrën. Një fakt tjetër i rëndësishëm që u nxor, ishte se qytetarët nuk e dinë se duke paguar një shumë ekstra prej pesë eurosh mund të kenë një transfer të shpejtë brenda gjashtë orësh.

U identifikuan arsye të ndryshme për vonesat. Mungesa e infrastrukturës doli si një barrierë e madhe. Përveç kësaj, është brenda interesit të bankave që të mbahen transferet.

"Paratë e thata janë të shtrenjta, pasi Kosova nuk mund të prodhojë paranë e vet", shpjegoi Liman Asllani.

Zv. Ministri për Tregti dhe Industri, Kadri Kryeziu, e mirëpriti studimin e KAP-it. "Këto janë fakte dhe të dhëna relevante për punën tonë", tha ai.



Zëvendës Ministri i Tregtisë dhe Industrisë mori pjesë në një debat për besueshmërinë e transferave bankare.

Florim Haxhariaj, përfaqësuesi i BPK-së, nuk u pajtua me gjetjet. Ai theksoi se institucioni i tij ka marrë vetëm pesë apo gjashtë ankesa për vonesat e transaksioneve. Megjithatë, asnjë bankë nuk është dënuar për këtë gjë. Në debatin që u pasua, doli se edhe pse BPK-ja e ka autoritetin për t'i dënuar bankat për vonesat në transfere, asnjë dënim nuk është shqiptuar.

Gjatë debatit, Oda Ekonomike e Kosovës, një shoqatë e pavarur e tregtisë dhe biznesit, premtoi se do të ofronte mbështetjen e vet në promovimin e studimit të KAP-it dhe gjetjen e një zgjidhjeje për problemin. ■

## Haradinaj, vijon nga f.1

theu pranë zyrave të UNMIK-ut në Prishtinë, që dëmtoi lehtë makinat përreth dhe plagosi një kalimtar. Tre ditë më vonë, ndodhi një incident pak më i rëndë rreth 50 metra larg zyrës së ATRC-së

në Prishtinë; një mjet plasës TNT shpërtheu ndërkohë që kolona e presidentit Ibrahim Rugova po shkonte për një takim të rëndësishëm së lartë. Dy njerëz u plagosën nga shpërthimi, dhe zy-

rat e ATRC-së u mbyllën pasi e tërë rruga atë ditë u shndërrua në vend krimi.

Ende, siç e kanë vënë re mediat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, gjendja nuk degradoi në atë pikë që frikësohej shumica. Për habinë e shumë njerëzve, nuk pati asnjë protestë masive të dhunshme, vetëm një protestë paqësore u organizua nga studentët e universitetit. Aktet e dhunës u kufizuan në institucione të caktuara dhe nuk patën përkrahje popullore.

Zgjidhja jo e dhunshme e një marsi tjetër të vështirë pasoi me zgjedhjen e një Kryeministri të ri, Bajram Kosumi, që bëri të mundur vazhdimin e koalicionit qeveritar. ■



Një bombë për makinat e Presidentit Rugova shpërtheu 30 metra nga zyra jonë në Prishtinë. (Foto e marrë nga Visar Kryeziu, EXPRESS).